



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr. 621 Prot.

Tiranë, më 15.06.2026

**V E N D I M**

**Nr. 167, Datë 15.06.2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.81 Regj., datë 27.03.2026 e znj. A. Z., kundër titullares së Agjencionë Kombëtare të Mjedisit znj. M. P., Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. E. Ö., në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “përgjegjësive prindërore” dhe “çdo shkak tjetër<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, ndër të tjera, informohemi se: *Pala ankuese, A. A. Z., (K.), nëpunëse civile dhe Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Çështjeve Gjyqësore në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), pretendon se është diskriminuar nga M. P., Drejtore e Përgjithshme e AKM-së, dhe E. Ö., Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për shkak të përgjegjësive të saj prindërore si nënë e një fëmije me nevoja të veçanta. Ajo pretendon se, megjithëse eprorët kanë qenë në dijeni të plotë të situatës së saj familjare, gjatë vitit 2025 është mbingarkuar me detyra shtesë, duke kryer paralelisht detyra të disa sektorëve, ndërsa me Urdhrin nr. 157, datë 13.03.2026, është ngarkuar të ushtrojë edhe detyrat e Sektorit Juridik në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, pa njoftim paraprak, pa pëlqimin e saj dhe pa arsytim të mjaftueshëm. Sipas saj, ky vendim, i marrë gjatë periudhës kur ndodhej në leje të zakonshme, së bashku me ngarkesat e mëparshme në punë, përbën trajtim selektiv, hakmarrës dhe diskriminues,*

<sup>1</sup> Me çdo shkak tjetër ankuesja ka pretenduar aftësinë e kufizuar të fëmijës së saj.

*pasi nuk merr në konsideratë nevojën e saj për t'u kujdesur për fëmijën me nevoja të veçanta dhe synon degradimin e saj profesional, krijimin e një mjedisi armiqësor pune dhe largimin e saj nga detyra.*

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Konstatimin e diskriminimit;
- Vlerësimin e Urdhrit nr. 157, datë 13.03.2026, si një akt të paligjshëm dhe diskriminues;
- Hetimin administrativ të procedurës së ndjekur nga eprorët në nxjerrjen e këtij urdhri;
- Garantimin e mbrojtjes nga veprimet të paligjshme që synojnë destabilizimin tim emocional dhe profesional si dhe largimin tim nga shërbimi civil për qëllime personale të eprorëve;
- Garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi të shkaktuar nga eprorët.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar dhe është pranuar për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara në nenin 33, pika 4, të këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 621/1 prot., datë 01.04.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur nga znj. A. A. Z. (K.) kundër Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të përgjegjësisë prindërore dhe situatës familjare, njoftoi Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe kërkoi paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit përkatës lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.
- Me shkresën nr. 5446/1 prot., datë 14.04.2026, administruar pranë Komisionerit me nr. 621/2 prot., datë 20.04.2026, Agjencia Kombëtare e Mjedisit paraqiti informacionin dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.
- Me email të datës 23.04.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i përcolli ankueses shkresën nr. 5446/1 prot., datë 14.04.2026 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim njohjen me përmbajtjen e saj dhe ushtrimin e së drejtës për të paraqitur parashtrimet dhe kundërshtimet përkatëse.
- Me email të datës 29.04.2026, ankuesja znj. A. A. Z., (K.) paraqiti pranë Komisionerit parashtrimet dhe qëndrimin e saj lidhur me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
- Me email të datës 19.05.2026, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi znj. A. A. Z., (K.) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit mbi ndryshimin e orarit të

seancës dëgjimore të planifikuar në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 81 Regj., datë 27.03.2026, duke bërë me dije se seanca do të zhvillohej më datë 21.05.2026, ora 12:00, në mjediset e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me email të datës 19.05.2026, ora 11:16, Agjencia Kombëtare e Mjedisit konfirmoi pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të znj. M. P., Drejtore e Përgjithshme e AKM-së, dhe znj. E. Ö., Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- Me email të datës 20.05.2026, ankuesja znj. A. A. Z., (K.) njoftoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi konfirmimin e pjesëmarrjes së saj në seancën dëgjimore të planifikuar për datën 21.05.2026.

Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e pales ankues dhe caktoi datën 21.05.2026, ora 12:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me email të datës 19.05.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua më datë 21.05.2026, ora 12:00, me pjesëmarrjen e palës ankuese, znj. A. A. Z. (K.), si dhe të palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuar nga znj. M. P., Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, dhe znj. E. O., Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjatë seancës, palët parashtruan dhe pasqyruan pretendimet, qëndrimet dhe argumentet e tyre lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, duke dhënë shpjegime dhe sqaruar faktet e rrethanat përkatëse. Në përfundim të seancës, palët u dakordësuan që znj. A. A. Z. (K.) t’i paraqesë, në ditët në vijim, znj. M. P., në cilësinë e titullares së institucionit, një kërkesë për përshtatje të arsyeshme të orarit të punës, në funksion të nevojave që lidhen me kujdesin dhe përkujdesjen ndaj fëmijës së saj me nevoja të veçanta, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit të shqyrtojë këtë kërkesë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundësitë organizative të institucionit.

Në vijim, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, me email të datës 21.05.2026, znj. A. Z. (K.) i paraqiti Drejtores së Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, znj. M. P., një kërkesë për përshtatje të arsyeshme të kushteve të punës, duke kërkuar lejimin e largimit nga puna 30 minuta përpara përfundimit të orarit zyrtar, për shkak të nevojës për kujdesin ndaj fëmijës së saj. Kjo kërkesë u paraqit në referim të Urdhrit nr. 170, datë 02.04.2026, si dhe rrethanave familjare të parashtruara gjatë shqyrtimit të ankesës.

Me email të datës 25.05.2026, ora 19:53, Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, znj. M. P., informoi znj. A. A. Z. (K.) se kërkesa e saj për orar fleksibël pune ishte pranuar dhe se, në zbatim të Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024, do të vijonte të përfitonte tolerancën për largim nga puna 30 minuta përpara orarit zyrtar. Gjithashtu, u kërkuar nga Drejtorja e Financës dhe

---

<sup>2</sup> Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

Shërbimeve Mbështetëse dhe struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore ndjekja e procedurave administrative përkatëse.

Me relacionin nr. 8244 prot., datë 26.05.2026, të hartuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, u dokumentua administrativisht miratimi i kërkesës së znj. A. A. Z. (K.) për largim nga puna 30 minuta përpara përfundimit të orarit zyrtar, duke pasqyruar bazën dokumentare dhe dakordësinë e titullares së institucionit lidhur me këtë përshtatje të arsyeshme të orarit të punës.

Pasi mori konfirmimin zyrtar të miratimit të orarit fleksibël, me email të datës 26.05.2026, znj. A. Z. njoftoi KMD-në se nuk gjendej më në kushtet e nevojshme për vijimin e shqyrtimit të ankesës dhe njoftoi për tërheqjen vullnetare të saj. Ajo falënderoi Komisionerin për trajtimin profesional dhe me diskrecion të çështjes, dhe shprehu besimin se kjo qasje pozitive institucionale do të garantonte trajtim të drejtë e respektim të të drejtave të punësimitëve edhe në të ardhmen.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.81 Regj., datë 27.03.2026 e znj. A. Z., kundër titullares së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit znj. M.

P., Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. E. Ö., në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “përgjegjësisë prindërore” dhe “çdo shkak tjetër”, pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**